



IADK Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës
Nr.02123 Data: 16/01/2023

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br. 40/23
Nr. i fq. / Br. st. -04-
Data: / Datum 16.01.2023
VUSHTRRI - VUČITRN

MARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIM – (MpB)

në mes të

- Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës, me regjistrim Nr: 5200122-6 – përfaqësuar nga z. Zenel Bunjaku, Drejtore, në tekstin e mëtejmë i referuar si “IADK”

dhe

- Komunës së Vushtrrisë, përfaqësuar nga z. Ferit Idrizi Kryetar i komunës, në tekstin e mëtejmë referuar si “Komuna e Vushtrrisë”

Neni 1
Lënda e MpB

IADK-ja dhe Komuna e Vushtrrisë (tani e tutje referuar si Palët) pajtohen të rregullojnë një bashkëpunim të afërt me qëllim të ngritjes së kapacitetave profesionale dhe përkrahjes me grante për fermerët, gratë, të rinjët dhe studentët në Komunën e Vushtrrisë.

Neni 2
Qëllimi

2.1 Kjo MpB ka qëllimin të përshkruajë bashkëpunimin në mes të Palëve gjatë periudhës 2023-2025, bazuar në zbatimin e projektit “Përmirësimi i punësimit dhe mundësive për gjenerim të të ardhurave në zonat rurale të Kosovës” i financuar nga Donatori BfdW nga Gjermania dhe zbatuar nga IADK, që do të shtrihet në komunat: Vushtrri, Skenderaj, Mitrovicë, Drenas, Podujevë dhe Suharekë. Përmes këtij projekti synohet ngritja e kapacitetave profesionale dhe përkrahja direkte me grante në sektorin e bujqësisë, përpunimit të prodhimeve bujqësore, digitalizimit të bujqësisë dhe ndryshimeve klimatike, si dhe përkrahja e studentëve me punë praktike.

2.2 Projekti do të arrij rezultate të prekshme, nga ku do të mbështeten:

- do të përkrahen 60 student të drejtimit të bujqësisë dhe teknologjisë ushqimore për të kryer punën praktike me pagesë për periudhë 3 mujore në kompani/ndërmarrje private që përshtaten me profesionin e tyre, me qëllim të punësimit dhe lehtësimit qasjes në tregun e punës,
- do të të mbështeten 104 fermer të vegjël me grante në vlerë mesatare nga 3,000.00 euro në sektorët më potencial të bujqësisë (pemë, perime, blegtori, bimë mjekësore), dhe do të marrin asistencë

Adresa:

Sfaraçak i Ulët nr.11
42000 Vushtrri

Te jetojmë nga loka e he puna janë!
Let us live from our land and work!

E-mail: info@iadk.org

Tel: 049777046 & 044777036

Web: www.iadk.org



profesionale (trajnime, këshilla direkte, monitorime, vizita studimore brenda vendi) me qëllim të prodhimit sa më të suksesshëm,

- do të trajnohen dhe aftësohen 45 gra në fushën e përpunimit dhe do të certifikohen,
- do të përkrahen tri (3) gra me pajisje në vlerë mestare nga 9,000.00 euro për ngritjen e njësive përpunuese (pemë, perime, qumësh,ëmbëlsira), nga do të punësohen 6 gra në këto njësi përpunuese të prodhimeve bujqësore,
- do të përkrahen tri (3) gra me grante në vlerë mestare nga 6,000.00 euro për përmirësimin e kapaciteteve përpunuese të pemëve dhe perimeve, nga do të punësohen 6 gra në këto njësi përpunuese të prodhimeve bujqësore,
- do të angazhohen ekspert të jashtëm për studim fizibiliteti për ndryshimet klimatike dhe për dixhitalizimin e bujqësisë, nga do të përkrahen fermerët për krijimin dhe promovimin e modeleve të ndryshme për të adresuar ndryshimet klimatike dhe digitalizimin në bujqësi, pastaj do të organizohen ditë fushore, tryeza të rrumbullakta, trajnime dhe broshura promovuese.

Neni 3

OBLIGIMET E KOMUNËS SË VUSHTRRISË

Bashkëfinancimi në grantet përkrahëse për përfituesit dhe aftësimin profesional të tyre

Komuna e Vushtrrisë gjatë viteve 2023-2025 në varësi të mundësive buxhetore do të bashkëfinancoj në projektet përkrahëse të IADK-së, të cilat do të shpërndahen për përfituesit e Komunës së Vushtrrisë. Në fillim të vitit/eve IADK në dakordim me drejtoren për bujqësi do të caktojnë numrin e përfituesve të granteve dhe sektorët më të nevojshëm për përkrahje të përfituesve, ndërsa mënyra e përkrahjes me grante dhe bashkëfinancimi do të jetë si vijon:

3.1 Për përkrahje me grante direkte për një përfitues/e, vlera mesatare e përkrahjes do të jetë 3,000.00 € (IADK 1,800.00 €, Komuna e Vushtrrisë 900.00 € dhe Përfituesi 300.00 €);

3.2 Për përkrahje me grante direkte për një përfitues të njësise përpunuese (pemë, perime, qumësh,ëmbëlsira, etj.), vlera mesatare e një granti për përfitueset do të jetë 9,000.00 € (IADK 5,850.00 €, Komuna e Vushtrrisë 2,250.00 € dhe Përfituesja 900.00);

3.3 Për përkrahje me grante direkte për një përfitues për përmirësim të kapaciteteve përpunuese (pemë dhe perime), vlera mesatare e një granti për përfitueset do të jetë 6,000.00 € (IADK 3,900.00 €, Komuna e Vushtrrisë 1,500.00 € dhe Përfituesja 600.00);

3.4 Shpenzimet operacionale (përgjedha e përfituesve, këshilla direkte, trajnime, vizita, komunikime, matriale edukuese, raportimet dhe monitorimet sipas kontrates me përfitues), do të llogariten sipas numrit të përfituesve dhe vlerës së grantit për përfituesin, ndërsa bashkëfinancimi do të jetë si vijon:

3.5 Në rastin e grantit në vlerë prej 3,000.00 € - shpenzimet operacionale do të janë 900.00 € (IADK 675.00 € dhe Komuna e Vushtrrisë 225.00 €);

3.6 Në rastin e grantit për njësi përpunuese në vlerë prej 9,000.00 € - shpenzimet operacionale përfshir këtu edhe trajnimin grupor prej 10-15 gra do të janë 2,700.00 € (IADK 2,025.00 € dhe Komuna e Vushtrrisë 675.00 €);

3.7 Në rastin e grantit për njësi përpunuese në vlerë prej 6,000.00 € - shpenzimet operacionale përfshir këtu edhe trajnimin grupor prej 10-15 gra do të janë 1,800.00 € (IADK 1,350.00 € dhe Komuna e Vushtrrisë 450.00 €);

Adresa:

Sfaraçak i Ulët nr.11
42000 Vushtrri



“Të jetojmë nga loka është puna jone!”
“Let us live from our land and work!”

E-mail: info@iadk.org

Tel: 049777046 & 044777036
Web: www.iadk.org



3.8 Numri i përfituesve (fermerëve, studentëve, grave, të rinjëve) do të varet nga buxheti në dispozicion të cilin IADK do ta siguroj nga donatorët (në këtë rast nga Donatori BfdW nga Gjermania), numrit të aplikacioneve, numrit të përfitueseve që plotësojnë kriteret;

3.9 Përzgjedhja e përfituesve do të bëhet nga komisioni i përbashkët me ekspert të IADK-së dhe Komunës së Vushtrrisë;

3.10 Komuna e Vushtrrisë do të kryej pagesat sipas obligimeve të cekura në nenin 3, pasi IADK të dorëzoj reportin dhe kërkesën për pagesë për projektet e realizuara me numrin e përfituesve;

3.11 Pagesa do të bëhet në TEB Bankë në depozitim në Nr.xhir:2027-000021-7128-84, në emër të IADK-së, dhe jo më vonë se fundi i muajit nëntor të vitit përkatës, kur realizohen projektet.

Neni 4 OBBLIGIMET E IADK-së

4.1 IADK do të organizoi një sesion informues përmes të cilit pjesëmarrësit do të njoftohen lidhur me qëllimin e projekteve, aktivitetet e projekteve, si dhe mënyrën se si mund të përfshihen në projekt;

4.2 IADK do të punojë ngushtë me Drejtoren e Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural të Komunës së Vushtrrisë në përzgjedhjen, monitorimin dhe mbikëqyrjen e aktivitetave të përfituesëve;

4.3 IADK është përgjegjëse për zbatimin dhe mbikëqyrjen e tërë procesit të furnizimit dhe shpërndarjes së artikujve, pajisjeve dhe materialeve që e përbëjnë paketat specifike për përfituesit e granteve;

4.4 IADK do të organizoi trajnime, këshilla direkte, vizita, monitorime të rregullta për përfituesit, si dhe ofron materiale të nevojshme trajnuese;

4.5 IADK do të angazhojë studentë drejtimit të bujqësisë dhe teknologjisë ushqimore për përkrahje me punë praktike me pagesë. Numri i tyre varet nga interesimi dhe plotësimi i kriterieve, ndërsa ata do të kryejnë praktikën vetëm në kompani/ndërmarrje private fushëveprintaria e të cilave përshtatet me profesionin e tyre;

4.6 Për punën praktike tremujore për çdo student të Komunës së Vushtrrisë, të përzgjedhur për përkrahje me punë praktike mbështetja financiare për shpenzime të transportit, ushqimit dhe komunikimit do të jetë 750.00 € nga IADK (250 €/1muaj);

4.7 IADK pas realizimit të projekteve do të raportoj tek Komuna e Vushtrrisë për rezultatet e arritura nga aktivitetet e realizuara në kudër të kësaj MpB.

Neni 5 Personat Kontaktues

5.1 Palët do të emërojnë nga një përfaqësues që të rregullojnë kontaktet më të lehta dhe të drejtpërdrejta në mes dy partnerëve. Këta persona do të përfshiheshin drejt për së drejti në implementimin e qetë dhe kohor të kësaj MpB.

5.2 IADK do të përfaqësohet nga Sylejman Bunjaku, ndërsa Komuna e Vushtrrisë nga Rabije Zahiti.

Neni 6 Pajtueshmëria me ligjin

6.1 Kjo marrëveshje do të zbatohet në pajtim me ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës.

6.2 Kjo marrëveshje nuk do të jetë në kundërshtim me asnjë marrëveshje bashkëpunimi që palët e kanë me palë të treta.

Adresa:

Sfaraçak i Ulët nr.11
42000 Vushtrri

Je jehojmë nga loka e së puna jenë!
Let us live from our land and work!

E-mail: info@iadk.org

Tel: 049777046 & 044777036

Web: www.iadk.org



Neni 7
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

7.1 Palët do të zgjidhin në mënyrë miqësore, me bisedime, të gjitha mosmarrëveshjet, kundërthëniet apo ankesat që dalin, apo janë të lidhura me këtë Marrëveshje.

7.2 Nëse njëra nga palët argumenton mos zbatimin e kësaj marrëveshjeje, dhe atë vetëm pas konsultimeve paraprake me palën tjetër, atëherë ajo palë mund të térhiqet nga marrëveshja.

Neni 8
Zgjatja amandamentimi dhe përfundimi i marrëveshjes

8.1 Palët minden, me marrëveshje të dyanshme me shkrim, të zgjasin apo ndryshojnë dhe plotësojnë këtë marrëveshje.

8.2 Në rast të mosmarrëveshjes/pakënaqësisë nga ndonjëra palë, MpB mund të ndërpritet para afatit të paraparë duke dhënë një njoftim me shkrim 1- muaj më parë.

Neni 9
Përpilimi

Kjo marrëveshje është e përpiluar në një ekzemplar origjinal në gjuhën Shqipe për çdo palë. Secila palë do ta ketë një ekzemplar origjinal në gjuhën Shqipe të nënshkruar dhe të vulosur.

Neni 10
Hyrja në fuqi

Kjo MpB përfshinë periudhën nga Janar 2023 deri në Dhjetor 2025, dhe hynë në fuqi nga data e nënshkrimit nga të dy palët.

Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK)



Zenel Bunjaku, Drejtëor Ekzekutiv

Vushtrri 16.01 2023



Vushtrri 18.01 2023